

# FINANCA

*Buletini Maja* | MARS 2026



## MINISTRI I FINANCAVE ZHVILLOI NJË KONFERENCË TË PËRBASHKËT PËR MEDIAT ME DREJTUESIT E ADMINISTRATËS TATIMORE DHE DOGANORE

Ministri Petrit Malaj zhvilloi një konferencë të përbashkët për media me drejtuesit e Administratës Tatimore dhe Doganore. Qëllimi i saj ishte prezantimi i performancës dymujore të vitit 2026, duke vënë theksin në rritjen e të ardhurave, përmirësimin e shërbimeve digjitale dhe zhvillimin e sistemeve përmes IA, si objektiva

strategjikë drejt arritjes së standardeve europiane. Ministri u shpreh se të ardhurat buxhetore kanë arritur nivele rekord, si rezultat i reformave strukturore, përmirësimit të administrimit dhe rritjes së ndërgjegjësimit fiskal, ndërsa informoi se janë mbi 1 miliardë euro të ardhura shtesë të cilat planifikohen të mblihen në buxhetin e shtetit përgjatë periudhës 2025–2026. Ministri theksoi se rritja e të ardhurave nuk vjen si rezultat i rritjes së taksave, por si rezultat i forcimit të miradministrimit tatimor dhe doganor, ndërsa përkthehen në më shumë investime, më shumë shkolla, më shumë spitale dhe më shumë mirëqenie për qytetarët shqiptarë.

▶ LEXO MË SHUMË

## MINISTRIA E FINANCAVE NGRE TASK FORCËN E PËRBASHKËT MES TATIMEVE DHE DOGANAVE PËR MONITORIMIN E TREGUT TË KARBURANTEVE

Ministria e Financave ka ngritur Task Forcën e përbashkët mes Tatimeve dhe Doganave, me qëllimin monitorimin e tregut të karburanteve në vend. Task Forca do të ketë në fokus rritjen e kontrollit dhe efikasitetit tatimor dhe doganor në sektorin e hidrokarbureve, në tregtimin me shumicë dhe pakicë,

në mënyrë që të shmangen rritjet abuzive të çmimit të tregtimit të karburanteve dhe të mbrohen interesat e qytetarëve shqiptarë. Ministri i Financave, Petrit Malaj, theksoi se ngritja e Task Forcës vjen edhe në kontekstin e zhvillimeve të fundit ndërkombëtare, të cilat kanë ndikuar në çmimet e hidrokarbureve. Grupet e përbashkëta të kontrollit do të fokusohen në garantimin që aktiviteti i subjekteve të zhvillohet në përputhje me ligjin, si dhe që çdo shitje të jetë e regjistruar fiskalisht dhe karburanti i tregtuar të përmbushë të gjitha detyrimet doganore dhe tatimore.

▶ LEXO MË SHUMË



## PERFORMANCA PARAPRAKE E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PËR JANAR-SHKURT 2026

Të ardhurat totale, për periudhën Janar-Shkurt 2026, arritën në rreth 130.3 miliardë lekë, 104.4 % e planit të periudhës ose 15.8 % e planit vjetor. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, u mblodhën rreth 13.4 miliardë lekë ose 11.5 % më shumë. Të ardhurat e arkëtuara nga Tatimet dhe Doganat, për muajt Janar-Shkurt 2026, janë në shumën 80.8 miliardë lekë, 3.1 miliardë lekë ose 3.9 % më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2025. Shpenzimet e përgjithshme publike, për periudhën dymujore të vitit 2026, arritën në rreth 100.6 miliardë lekë me një realizim në masën rreth 92 % e planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025 ky zë ka rezultuar 7.2% e më i lartë ose rreth 6.7 miliardë lekë më shumë.

▶ LEXO MË SHUMË



## MOODY'S RIKONFIRMON VLERËSIMIN E SHQIPËRISË NË "BA3" ME PERSPEKTIVË "TË QËNDRUESHME"

Agjencia ndërkombëtare e vlerësimit të kreditit Moody's Ratings ka rikonfirmuar vlerësimin afatgjatë të kreditit sovran të Shqipërisë në "Ba3" me perspektivë "të qëndrueshme". Moody's vlerëson qëndrueshmërinë e ekonomisë shqiptare dhe parashikon një rritje të PBB-së reale prej

3.6% për vitin 2025 dhe 3.5% për vitin 2026. Perspektiva e rritjes ekonomike do të mbështetet kryesisht nga ecuria e sektorit të turizmit, fluksi i qëndrueshëm i IHD-ve, veçanërisht në energji dhe turizëm, por edhe nga normat më të larta të pjesëmarrjes në tregun e punës. Agjencia vlerëson se, në aspektin fiskal, zbatimi i buxhetit ka mbetur i kujdesshëm gjatë vitit 2025 dhe parashikon një ulje të mëtejshme graduale të borxhit publik në tre-pesë vitet e ardhshme, të mbështetur nga respektimi i kuadrit të kujdesshëm fiskal nga qeveria.

▶ LEXO MË SHUMË



## S&P RIKONFIRMON VLERËSIMIN E SHQIPËRISË NË "BB" DHE PERSPEKTIVË "TË QËNDRUESHME"

Agjencia e vlerësimit të kreditit "Standard & Poor's Global Ratings" ka rikonfirmuar vlerësimin afatgjatë të kreditit sovran të Shqipërisë në "BB", duke ruajtur gjithashtu një perspektivë "të qëndrueshme". Ky vlerësim pasqyron besimin e vazhdueshëm

të agjencisë në stabilitetin makroekonomik të Shqipërisë. S&P vlerëson se ekonomia shqiptare ka treguar qëndrueshmëri ndaj goditjeve të njëpasnjëshme në vitet e fundit, duke përfshirë tërmetin e vitit 2019, pandeminë COVID-19 dhe krizën e çmimeve të energjisë. Në aspektin e rritjes ekonomike, S&P parashikon një rritje të PBB-së reale prej 3.7% për vitin 2025 dhe mbi 3% për periudhën 2027-2029.

▶ LEXO MË SHUMË



## MINISTRI PETRIT MALAJ: MONITORIM TË TREGUT TË KARBURANTEVE PËR TË SHMANGUR RITJET ABUZIVE TË ÇMIMEVE

Ministri i Financave mori pjesë në takimin e zhvilluar me furnizuesit e naftës për impaktin e krizës aktuale globale, me pjesëmarrjen edhe të Kryeministrit Rama. Në fjalën e tij, Ministri Malaj vuri në dukje faktin se Ministria e Financave tashmë ka ngritur Task Forcën mes Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në funksion të monitorimit të situatës në tregun e hidrokarbureve në vend. Plani Operacional i Task Forcës, tha z. Malaj, do të zbatohet në dy drejtime kryesore: në monitorimin e çmimeve dhe të marzheve të fitimit të aplikuara nga tregtarët me shumicë dhe me pakicë të hidrokarbureve, si dhe në rritjen e efikasitetit dhe kontrollit tatimor dhe doganor, me qëllim uljen e evazionit fiskal apo kontrabandës në këtë sektor.

▶ LEXO MË SHUMË



## MINISTRI MALAJ NË BRUKSEL: SHQIPËRIA, PROGRES TË QËNDRUESHËM NË DREJTIM TË KONVERJENCËS ME BE

Ministri i Financave, z. Petrit Malaj, mori pjesë në panelin e nivelit të lartë me temë "Zgjerimi dhe zhvillimi: Çfarë na diktojnë shifrat", i cili u zhvillua në Bruksel, nën drejtimin e Komisioneres znj. Marta Kos. Në diskutimin e tij, z. Malaj u fokusua në progresin e qëndrueshëm që vendi ynë po bën drejt arritjes së konvergencës me Bashkimin Europian. Në këtë kuadër, Ministri theksoi se Shqipëria ka shënuar një transformim të madh në dekadën e fundit, duke tejkaluar mesataren e BE-së sa i përket rritjes reale të PBB-së. Ministri u shpreh se konsolidimi fiskal mbetet një shtysë kryesore në menaxhimin e financave publike dhe vuri në dukje faktin se borxhi publik u ul në 53% të PBB-së në vitin 2025, nga 74% që ishte në fund të vitit 2021, ndërsa deficitit buxhetor pritet të mbetet në nivele të ulëta në vitet në vijim, duke reflektuar disiplinën fiskale dhe stabilitetin makroekonomik të vendit.

▶ LEXO MË SHUMË



## MINISTRI PETRIT MALAJ TAKOHET ME EKIPIN E BANKËS BOTËRORE, DISKUTIME MBI BASHKËPUNIMIN DYPALËSH

Ministri i Financave zhvilloi një takim pune me një ekip të Bankës Botërore, ku u diskutua mbi ecurinë e bashkëpunimit të deritanishëm mes qeverisë shqiptare dhe BBB, në mënyrë të veçantë mbi mbështetjen financiare në drejtim të politikave zhvillimore të vendit. Ministri Malaj vlerësoi bashkëpunimin dhe mbështetjen që ky institucion

ndërkombëtar ka dhënë dhe po jep aktualisht për zbatimin e reformave të ndërmarra nga qeveria, si dhe theksoi rëndësinë e këtij partneriteti për përsheptimin e procesit të integritetit të Shqipërisë në BE. Bashkëpunimi me BB është i harmonizuar me Programin e Qeverisë 2025–2029 dhe synon përsheptimin e rritjes së qëndrueshme, forcimin e stabilitetit fiskal, krijimin e vendeve të punës më produktive e më të paguara, rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit privat dhe avancimin e qëndrueshmërisë mjedisore.

▶ LEXO MË SHUMË

## MINISTRI MALAJ PREZANTON NË KUVEND MARRËVESHJEN PËR FINANCIIMIN E PROGRAMIT "INFRASTRUKTURA BASHKIAKE V – FAZA II"

Ministri i Financave prezantoi në Kuvend projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave (huamarrësi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin "Infrastruktura bashkiake V – faza II". Përmes kësaj marrëveshjeje mundësohet një financim prej 47

milionë euro për programin e mësipërm, i cili ka një rëndësi strategjike për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve. Programi synon përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm, modernizimin e sistemeve të kanalizimeve dhe mbrojtjen e mjedisit, duke kontribuar gjithashtu në zhvillimin ekonomik rajonal dhe mbështetjen e sektorit të turizmit. Investimet do të fokusohen në disa qytete të vendit, duke garantuar shërbime më të qëndrueshme dhe standarde më të larta infrastrukturore për komunitetet përfituese.



▶ LEXO MË SHUMË